

## **LIGJI PER LOBIM**

### **I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

#### **Neni 1**

(1) Me kete ligj rregullohen kushtet per marrjen e statusit te lobistit dhe organizates se lobit, regjistrimin e lobistev e dhe organizatave te lobit, detyrimet e lobistev e dhe ogranizatave te lobit dhe detyrimet e personave dhe organeve te te cilet lobohet, me qellim transparencen e proceseve te pergatitjes, miratimit dhe ndryshimit te politikave publike, perkatesisht programeve, ligjeve, akteve nenligjore ose akteve te tjera te pergjithshme.

(2) Ky ligj ka te beje me lobimin tek organet e pushtetit legjislativ, pushtetit ekzekutiv dhe organet e njesive te veteqeverisjes lokale.

#### **Kuptimi i shprehjeve te ketij ligji**

#### **Neni 2**

(1) Me nocionin "person te i cili lobohet", nenkuptohet personi i zgjedhur apo i emeruar, sekretar i njesise se veteqeverisjes lokale, sekretar i pergjithshem apo shteteror, keshilltari i vecante ose nepunesi i kabinetit.

(2) Me nocionin "organi te i cili lobohet", nenkuptohet organi i pushtetit legjislativ, ekzekutiv ose organi i njesise se veteqeverisjes lokale.

(3) Me nocionin "kontakt", nenkuptohet komunikimi i drejtperdrejte apo i terthorte, pa dallim te lokacionit ku realizohet, menyra dhe mjeti i komunikimit qe shfrytezohet.

(4) Per percaktimin e domethenies se nocionit "keshilltar i vecante" zbatohen dispozitat e Ligjit te te Punesuarve ne Sektorit Publik.

(5) Per percaktimin e domethenies se nocionit "nepunes i kabinetit" zbatohen dispozitat e Ligjit te Nepunes Administrative.

(6) Me "qendrim, perkatesisht mendim te shprehur publikisht", nenkuptohet qendrimi, perkatesisht mendimi i shprehur ne tubim publik, ngjarje publike, seance publike, tubimi i qytetareve ose permes mjeteve per informimin publik, permbajtja e publikuar ne faqen e internetit, te e cila qasja eshte publike dhe nuk eshte e kufizuar dmth. postera, fletushke ose banderole e shperndare publikisht.

(7) Per percaktimin e domethenies se shprehjes "konflikt i interesave" zbatohen dispozitat e Ligjit te Parandalimit te Korrupsionit dhe te Konfliktit te Interesave.

#### **Definicioni per lobimin**

#### **Neni 3**

(1) Lobimi paraqet aktivitet per qellimin e realizimit te ndikimit mbi proceset e pergatitjes, miratimit dhe ndryshimit te:

- ligjeve, akteve nenligjore ose akteve te tjera te pergjithshme,
- politikave perkatesisht programeve publike qe i miratojne organet te te cilet lobohet, ne vecanti kur keto politika, d.m.th. keto programe kane te bejne me planifikimin hapesinor dhe urbanistik, zhvillimin dhe ndarjen, perkatesisht shperndarjen e mjeteve publike.

(2) Lobimi nenkupton kontakt me personin tek i cili lobohet, me qellim ndikimin konkret te drejtuar mbi procesin perkatesisht mbi permbajtjen e politikave perkatesisht programeve publike, dispozitave dhe akteve te tjera nga paragrafi (1) i ketij neni, ndersa ky kontakt realizohet jashte procedures se percaktuar dhe filluar, d.m.th. procedura edhe nuk paraqet qendrim, perkatesisht mendim te kumtuar publik, as pjesemarrje me thirrje, perkatesisht kerkese te organit, tek i cili lobohet ne punen e pergatitjes, shqyrtimit

ose kerkimit, perkatesisht dhenies se informatave faktografike, perkatesisht te dhenave ose mendimeve profesionale per iniciativa dhe zgjidhje te propozuara per politika publike, programe, ligje, dispozita te tjera dhe akte te pergjithshme.

(3) Lobimi nuk paraqet, perkatesisht nuk ka te beje me:

- a. procedura gjyqesore ose administrative, procedura qe zbatohen ne pajtim me rregullat, qe rregullojne prokurimet publike dhe procedurat ne te cilat vendoset per te drejtat dhe obligimet e individeve;
- b. komunikimin me qytetarin lidhur me realizimin e te drejtave individuale;
- c. komunikimin, zbardhja e te cilit mund te paraqese kercenim per sigurine, per cilindo person ose per sigurine e shtetit;
- c. initiative qytetare e ngritur ne pajtim me ligjin;
- d. komunikimin me sindikatat, perkatesisht me perfaqesues te sindikatave kur i perfaqesojne interes e anetareve te tyre ne negociata per kushtet e punesimit dhe punes; dh. komunikimin ndermjet personave zyrtare ne organin e pushtetit legjislativ, organin e pushtetit ekzekutiv ose organin e njesise se veteqeverisjes lokale qe e realizojne ne kuader te fusheveprimit te vet te detyrave te punes, perkatesisht funksioneve; e. komunikimin ndermjet anetareve te emeruar, perkatesisht te caktuar ne trupat e formuar nga organet e pushtetit legjislativ, organet e pushtetit ekzekutiv ose organet e njesive te veteqeverisjes lokale, per qellimet e shqyrtimit, vleresimit dhe analizes se ceshtjeve te politikes publike, per shkak te njoftimit te organeve prej te cilave trupat jane formuar;
- e. komunikimin me ose ne emer te organizatave nderkombetare;
- f. komunikimin me ose ne emer te partise politike;
- gj. Komunikimin ndermjet shoqatave dhe fondacioneve, te regjistruara ne pajtim me Ligjin e Shoqatave dhe te Fondacioneve, me perfaqesuesit, perkatesisht, organet e pushtetit ligjvenes, pushtetit ekzekutiv dhe organet e njesive te veteqeverisjes lokale.

#### **Neni 4**

- (1) Lobim mund te kryejne vetem lobiste te regjistruar ne pajtim me dispozitat e ketij ligji.
- (2) Me perjashtim te paragrafit (1) te ketij neni, ne emer dhe per llogari te organizates se lobit, lobim mund te kryeje perfaqesuesi ligjor, i punesuari ose personi i autorizuar i organizates se lobit (ne tekstin e meteje: perfaqesuesi i organizates se lobit).
- (3) Qe te kryeje lobim, perfaqesuesi i organizates se lobit regjistrohet ne Regjistrin e lobisteve, organizatave te lobit dhe lobimit, ne pajtim me dispozitat e ketij ligji.
- (4) Per percaktimin e obligimeve te perfaqesuesit te organizates se lobit, gjate lobimit, zbatohen dispozitat e ketij ligji te cilat i percaktojne obligimet e lobisteve dhe organizatave te lobit.

Porositesit e lobimit

#### **Neni 5**

- (1) Porositesi i lobimit eshte personi fizik ose juridik i cili angazhon lobiste ose nje organizate lobimi per kryerjen e lobimit mbi baze te kontrates se lidhur me shkrim.
- (2) Porositesit nga paragrafi (1) i ketij neni i jepet autorizim i lobistit perkatesisht organizates se lobit, qe t'i perfaqesojne interesat e tij para organeve te te cilat lobon.

## II. KUSHTET PER MARRJEN E STATUSIT TE LOBITIT OSE ORGANIZATES SE LOBIT

### Neni 6

- (1) Lobist mund te jete nje person fizik, i cili eshte i afte per pune.
- (2) Nje organizate lobiste mund te jete nje person juridik i regjistruar ne Regjistrin Qendror te Republikes se Maqedonise se Veriut (ne tekstin e metejme: Regjistri Qendror).
- (3) Personat juridike dhe fizike te huaj mund te llobojne, me kusht qe te jene te regjistruar si organizate e lobit, respektivisht lobist, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji.

### Neni 7

- (1) Personat e zgjedhur dhe te emeruar, sekretare ne njesite e veteqeverisjes lokale, sekretaret e pergjithshem, sekretaret shteterore, personat pergjegjes ne ndermarrje publike ose institucione publike te themeluara nga organi te i cili llobohet dhe personat pergjegjes ne organizatat me autorizime publike nuk mund te llobojne gjate mandatit te tyre.
- (2) Personat nga paragrafi (1) i ketij neni mund te kryejne lobim pas skadimit te tre viteve nga dita e nderprerjes se mandatit.
- (3) Personat e punesuar dhe keshilltaret e vecante, ne organin ne te cilen llobohet, nuk mund te kryejne lobim nderkohe qe jane te punesuar ne ato organe.
- (4) Personat e permendur ne paragrafin (3) te ketij neni nuk mund te kryejne lobim para skadimit te nje viti nga dita e nderprerjes se mandatit te tyre.

## III. REGJISTRIMI I LOBISTEVE, ORGANIZATAVE TE LOBIT DHE LOBITIT

### Regjistri i lobisteve, organizatave te lobit dhe lobimit

### Neni 8

- (1) Lobistet dhe organizatat e lobit regjistrohen me regjistrim ne Regjistrin e lobisteve, organizatave te lobit dhe lobimit (ne tekstin e metejme: Regjistri).
- (2) Regjistrin e mban Komisioni Shteteror per Parandalimin e Korrupsionit (ne tekstin e metejme: Komisioni Shteteror).
- (3) Regjistri permбан:
  - a. te dhena per lobiste dhe organizatat e lobit:
    - te dhena te cilat mblidhen me fleteparaqitje per regjistrim ne regjister (neni 9),
    - daten dhe numrin e aktvendimit per regjistrim ne Regjister,
    - daten dhe numrin e aktvendimit per shlyerje nga Regjistri,
    - arsyet per shlyerje nga Regjistri dhe te dhenat per procedure gjyqesore te ngritura kunder aktvendimit te miratuar dhe rezultatit te procedures;
  - b. procesverbalet nga kontaktet e realizuara me qellim lobimi (neni 20);
  - c. raportet per aktivitetet e lobisteve dhe organizatave te lobit (neni 16);
    - c. aktet e brendshme te miratuara, te cilat rregullojne procedurat per realizimin dhe evidence te kontakteve me qellim lobimi ne organet te te cilat llobohet (neni 24).
- (4) Formen dhe menyren e mbajtjes se Regjistrit i percakton Komisioni Shteteror.

(5) Regjistri publikohet ne faqen e internetit te Komisionit Shteteror, me perjashtim te te dhenave qe jane te mbrojtura ne pajtim me ligjin.

(6) Te dhenat e regjistruara ne Regjister dhe dokumentacioni i bashkengjitur me to, ruhen ne pajtim me ligjin dhe ne nje afat prej dhjete vjetesh pas fshirjes se lobistit, perkatesisht organizates se lobit nga Regjistri.

(7) Azhurnimi i te dhenave ne Regjister dhe terheqja e te dhenave nga Regjistri qe jane publikuar ne faqen e internetit te Komisionit Shteteror, kryhet ne perputhje me nenin 12 te ketij ligji.

## **Regjistrimi ne Regjister**

### **Neni 9**

(1) Fleteparaqitja per regjistrim ne regjister paraqitet te Komisioni Shteteror.

(2) Fleteparaqitja e parashtruar ne paragrafin (1) te ketij neni per regjistrimin e lobistit permban:

- emrin, mbiemrin dhe numrin e amzes te personit i cili paraqitet per lobist,
- shtetesine e personit i cili paraqitet per lobist,
- adresen e vendbanimit dhe vendqendrimin te personit i cili paraqitet per lobist dhe adresen e imeilit per kontakt,
- fushat per te cilat personi aplikon per lobist deshiron ta regjistroje interesin e tij per kryerjen e lobimit,
- deklarate e nenshkruar me te cilen personi konfirmon mosekzistimin e kufizimeve per kryerjen e lobimit ne perputhje me nenin 7 te ketij ligji.

(3) Fleteparaqitja ne perputhje me paragrafin (1) te ketij neni per regjistrimin e nje organizate lobimi permban:

- emertimin dhe numrin e amzes te personit juridik i cili paraqitet per organizate lobimi,
- adresen e selise se vertete te personit juridik i cili paraqitet per organizate lobimi dhe adresen e imeilit per kontakt,
- fushat per te cilat personi juridik paraqitet per organizate lobimi deshiron ta regjistroje interesin e tij qe te kryej lobim,
- listen me emrin dhe mbiemrin, numrat e amzes, adresat e vendbanimit dhe vendqendrimin te personave qe jane regjistruar si perfaqesues te organizates se lobit, me deklarata te bashkengjitura e te nenshkruara, me te cilat personat e konfirmojne individualisht mosekzistimin e kufizimeve per kryerjen e lobimit, ne perputhje me nenin 7 te ketij ligji.

(4) Me kerkesen nga paragrafi (2) te ketij neni, paraqitet edhe nje fotokopje e dokumentit te identifikimit te personit fizik qe paraqitet per lobim.

(5) Me kerkesen nga paragrafi (3) i ketij neni paraqitet edhe nje fotokopje e dokumenteve per identifikimin e personave qe regjistrohen si perfaqesues te organizates se lobimit dhe deshmi per regjistrim te personit juridik nga Regjistri Qendror, perkatesisht regjister tjeter kompetent nese paraqitet person i huaj.

(6) Personi i huaj qe paraqet fleteparaqitje nga paragrafi (1) i ketij neni, paraqet edhe perkthim te verifikuar te shtojcave nga paragrafi (4), perkatesisht paragrafi (5) i ketij neni.

(7) Formen dhe permbajtjen e formularit per fleteparaqitjen dhe deklaratat nga ky nen, i percakton Komisioni Shteteror.

## **Neni 10**

- (1) Komisioni Shtetëror kontrollon kompletimin e fletëparaqitjeve të pranuar në Regjister në bazë të të dhënave të fletëparaqitjes dhe të dhënave nga Regjistri.
- (2) Nëse Komisioni Shtetëror pas kontrollit nga paragrafi (1) i këtij neni konstaton se parashtruesi i fletëparaqitjes për regjistrim në Regjister, i plotëson kushtet nga nenet 6 dhe 7 të këtij ligji dhe parashtruesit nuk i pezullohet e drejta e regjistrimit të serishëm në Regjister (neni 13 paragrafet (5) dhe (6) të këtij ligji), në afat prej tetë ditësh nga dita pranimit të kërkesës, miraton aktvendim për regjistrimin e lobistit, gjegjësisht organizatës së lobit në Regjister.
- (3) Regjistrimi i lobistit, gjegjësisht i organizatës së lobit në Regjister, kryhet në ditën e miratimit të aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni.

## **Neni 11**

- (1) Nëse Komisioni Shtetëror konstaton se fletëparaqitja për regjistrim në Regjister nuk i përmban të gjitha të dhënat dhe shtojcat e nevojshme në përputhje me nenin 9 të këtij ligji ose kur në listen nga neni 9 paragrafi (3) të këtij ligji, është shënuar për përfaqësues të organizatës së lobit personi për të cilin është pezulluar e drejta për t'u regjistruar serish në Regjister (neni 13 paragrafet (5) dhe (6) të këtij ligji), Komisioni Shtetëror do ta njoftojë dhe do ta ftojë parashtruesin e fletëparaqitjes për regjistrim në Regjister ku në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit, ta komplettojë, përkatësisht ta korrigjojë fletëparaqitjen.
- (2) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes për regjistrim në Regjister nuk vepron në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, Komisioni Shtetëror do të miratojë aktvendim me të cilin do ta hedhë poshtë fletëparaqitjen për regjistrim në Regjister.
- (3) Aktvendimi nga paragrafi (2) i këtij neni është final.
- (4) Nëse Komisioni Shtetëror konstaton se parashtruesi i fletëparaqitjes për regjistrim në Regjister, nuk i plotëson kushtet nga nenet 6 dhe 7 të këtij ligji, ose e drejta e regjistrimit i është pezulluar në pajtim me nenin 13, paragrafet (5) dhe (6) të këtij ligji, do të miratojë aktvendim me të cilin do ta refuzojë fletëparaqitjen për regjistrim në Regjister.
- (5) Kunder aktvendimit nga paragrafet (2) dhe (4) të këtij neni, parashtruesi i fletëparaqitjes për regjistrim në Regjister, ka të drejtë padie të Gjykatës Administrative, brenda 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

## **Perditesimi i Regjistrimit**

### **Neni 12**

- (1) Lobistet dhe organizatat e lobit janë të detyruara që brenda tri ditësh pune ta paraqesin të Komisioni Shtetëror cdo ndryshim në të dhënat, të cilat për ta janë të regjistruara në Regjister.
- (2) Komisioni Shtetëror vepron sipas fletëparaqitjes nga paragrafi (1) i këtij neni me azhurnimin e të dhënave në Regjister pa zgjatje, e me se voni brenda tri ditësh pune nga pranimi i fletëparaqitjes.
- (3) Të dhënat të cilat janë publikuar për lobist, përkatësisht organizatë lobi, për të cilën është miratuar aktvendim për shlyerje nga Regjistri në përputhje me dispozitat e këtij ligji, terhiqen nga faqja e internetit e Komisionit Shtetëror në ditën e miratimit të aktvendimit.

## **Shlyerje nga Regjistri**

### **Neni 13**

- (1) Komisioni Shtetëror miraton aktvendim për shlyerjen e lobistit, përkatësisht organizatës së lobit nga Regjistri në rast se:

- a. Komisioni Shtetëror konstaton se të dhënat dhe shtojcat nga fletëparaqitja e parashtruar për

regjistrim ne Regjistrin jane te paverteta;

- b. Komisioni Shteteror konstaton se lobisti, perkatesisht organizata e lobit tanime nuk i ploteson kushtet per regjistrim ne Regjistrin, ne pajtim me nenet 6 dhe 7 te ketij ligji;
- c. Komisioni Shteteror konstaton se lobisti perkatesisht organizata e lobit ka vepruar ne kundershtrim me dispozitat e neneve 14 dhe 15 te ketij ligji;  
c. Lobisti, perkatesisht organizata e lobit nuk vepron pas kerkeses se Komisionit Shteteror per informata plotesuese per kontrollin e kompletimit dhe vertetesise se raportit nga neni 16 i ketij ligji, ose ne menyre tjeter i pengon kontrollin nga paragrafi (2) i ketij neni, neni 18 ose neni 22 te ketij ligji, ose
- d. lobisti ose organizata e lobit parashtrohet kerkese me shkrim per shlyerjen nga Regjistri.
  - (2) Komisioni Shteteror i percakton rastet nga paragrafi (1) pikat a., b. dhe c. te ketij neni pas parashtreses se marre ose pas informates se arritur, brenda 20 ditesh, pas kontrollit te kryer e te zbatuar ne pajtim me nenin 18 te ketij ligji.
  - (3) Per qellimet e kontrollit nga paragrafi (2) i ketij neni, lobistet, organizatat e lobit, perfaqesuesit e organizatave te lobit, porositesit e lobimit dhe organet shteterore, jane te detyruara te veprojne sipas kerkeses se Komisionit Shteteror brenda 15 ditesh nga pranimi i kerkeses.
  - (4) Komisionit Shteteror e miraton aktvendimin nga paragrafi (1) i ketij neni, brenda tri ditesh nga pranimi i kerkeses per shlyerje nga Regjistri perkatesisht nga percaktimi i rastit nga paragrafi (1) i ketij neni.
  - (5) Per lobistin, perkatesisht organizaten e lobit te cilet jane shlyer nga Regjistri, suspendohet e drejta per regjistrim te serishem ne Regjister si lobist, organizate lobi ose perfaqesues te organizates se lobit, ne kohezgjatje prej nje viti nga dita e miratimit te aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni.
  - (6) Me aktvendimin nga paragrafi (1) i ketij neni te miratuar per organizaten e lobit, percaktohet pezullimi nga paragrafi (5) i ketij neni edhe per perfaqesuesin e organizates se lobit per te cilet Komisioni Shteteror ka konstatuar se ka qene i perfshire, perkatesisht ka kontribuar ne rastin per te cilin eshte miratuar aktvendim per shlyerjen e organizates se lobit nga Regjistri.
  - (7) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni lejohet padi ne Gjykatën Administrative ne afat prej 30 ditesh nga pranimi i aktvendimit.

#### IV. OBLIGIME TE LOBITIT DHE ORGANIZATES SE LOBIT

##### **Neni 14**

- (1) Per shkak te lobimit, lobisti, perkatesisht organizata e lobit nuk mund te pranoje, jape, premtoje, donacione, dhurata, sherbime, ndikime ose privilegje te tjera ose perparesi per vete ose per te tjere.
- (2) Lobisti, perkatesisht organizata e lobit nuk mund te propozoje ose te ndermarre aktivite ose te organizoje dhe realizoje kontakte me te cilat do ta vendose personin, i cili ben lobim, ne gjendje te konfliktit te interesave ose do t'ia shkaktoje ndjenjen e obligimit ndaj lobistit perkatesisht organizates se lobit.
- (3) Ndalohet lobimi i njekohshem, perkatesisht paralel lidhur me ceshtjen e njejte ne sferen e caktuar drejtuar realizimit te interesave te kundervena.

##### **Neni 15**

- (1) Lobisti, perkatesisht organizata e lobit nuk mund t'u jape informata te paverteta ose te paplota personave te te cilet ka lobuar lidhur me statusin e cilesise ne te cilin lobon ose per porositesin ne emer te te cilit lobon.

(2) Lobisti, perkatesisht organizata e lobit nuk mund te shfrytetoje ose zbuloje informata ose dokument te cilin e ka marre nga personi te i cili ka lobuar, ne kundersizim me qellimet per te cilat e ka marre informaten, perkatesisht dokumentin.

#### **Neni 16**

(1) Lobisti, perkatesisht organizata e lobit eshte e detyruar qe ne Komisionin Shteteror te dorezoje raport me shkrim per aktivitetin e vet deri me 31 janar ne vitin rrijedhes, per vitin paraprak, dhe brenda 30 ditesh nga dita e shlyerjes nga Regjistri, pa marre parasysht shkaqet per shlyerje.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i ketij neni, permban:

- te dhena per identitetin e lobistit perkatesisht organizates se lobit dhe perfaqesuesve te organizates se lobit te cilet kane lobuar ne emer te saj, me numer dhe date te aktvendimit per regjistrim ne Regjister,
- te dhena per identitetin e porositesve te lobimit, me te dhena per fushen dhe lenden e lobimit ne emer te secilit nga porositesit,
- te dhena per organet te te cilat eshte lobuar, te dhena per te gjitha personat te te cilet eshte lobuar dhe cilat veprime per lobim jane ndermarre,
- te dhena per shumen e pagesave per secilen pune te marre nga porositesi ne emrin e te cilit eshte lobuar. Nese lobimi eshte pjese e marreveshjes per sherbime te pergjithshme qe nenkupton edhe aktivite te tjera, ndersa vleresimi i lobimit nuk mund te caktohet, lobisti do te parashtroje te dhena per vleren e marreveshjes se plote te sherbimeve dhe perqindjes se kohes se kaluar per lobim lidhur me sherbimet e tjera nga ajo marreveshje.

(3) Lobisti, perkatesisht organizata e lobit detyrohen ta ruajne dokumentacionin ne baze te te cilit e kane perpiluar raportin nga paragrafi (1) i ketij neni, ne afat prej pese vitesh nga dita kur eshte parashtuar raporti.

(4) Formen dhe permbajtjen e formularit per raportin nga paragrafi (1) i ketij neni, i percakton Komisioni Shteteror.

(5) Raporti nga paragrafi (1) i ketij neni eshte informate me karakter publik.

#### **Neni 17**

(1) Komisioni Shteteror kryen kontroll formal te raportit nga neni 16 i ketij ligji gjate pranimit te tij.

(2) Nese Komisioni Shteteror gjate kontrollit nga paragrafi (1) i ketij neni konstaton se raporti eshte i paplote, do te njoftoje dhe do te kerkoje nga lobisti ose organizata e lobit ku brenda 15 ditesh nga pranimi i njoftimit te dorezoje raport te plote.

#### **Neni 18**

(1) Komisioni Shteteror pas informates se arritur ose parashtreses se pranuar e kontrollon kompletimin dhe vertetesine e te dhenave nga raporti nga neni 16 i ketij ligji, me:

- keqyrje ne dokumentacionin nga neni 16 paragrafi (4) i ketij ligji,
- kerkese per dorezimin e te dhenave plotesuese nga lobisti perkatesisht organizata e lobit,
- kerkese per dorezimin e te dhenave nga porositesit ne emrin e te cileve lobisti, perkatesisht organizata e lobit ka lobuar,
- kerkese per dorezimin e te dhenave nga organet dhe/ose personat te te cilet lobisti, perkatesisht organizata e lobit ka lobuar ose
- kerkese per dorezimin e te dhenave nga partite politike dhe organizatoret e fushatave zgjedhore dhe te referendumit.

(2) Personi, perkatesisht organi, si dhe partia politike, perkatesisht organizatori i fushates zgjedhore ose te referendumit te i cili Komisioni Shteteror ka dorezuar kerkese nga paragrafi (1) i ketij neni, eshte i detyruar te pergjigjet brenda 15 ditesh nga pranimi i kerkeses.

(3) Per qellimet e kontrollit nga paragrafi (1) i ketij neni, Komisioni Shteteror mund te kerkoje te dhena edhe nga organe te tjera shtetere, pervec organeve nga paragrafi (1) i ketij neni.

(4) Organet nga paragrafi (3) i ketij neni, jane te detyruara te veprojne sipas kerkeses se Komisionit Shteteror brenda 15 ditesh nga pranimi i kerkeses.

## V. OBLIGIME TE PERSONIT TE I CILI LOBOHET

### Neni 19

(1) Personi tek i cili lobohet eshte i detyruar te kete kujdes te mos vendoset ne gjendje te konfliktit te interesave gjate lobimit, duke marre parasysh qellimet e lobimit te cilat i kryen lobisti, perkatesisht organizata e lobit e cila e kontakton.

(2) Ne rast te gjendjes nga paragrafi (1) i ketij neni, personi te i cili lobohet eshte i detyruar ta nderprese kontaktin dhe te refuzoje cfaredo qofte kontakti te metutjeshem me lobistin, perkatesisht organizaten e lobit dhe perfaqesuesin e organizates se lobit.

### Neni 20

(1) Per secilin kontakt me qellim lobimin, personi te i cili lobohet eshte i detyruar te pergatise procesverbal nga kontakti i realizuar me qellim lobimin i cili i permban te dhenat si ne vijim:

- emrin, mbiemrin dhe vendin e punes se personit te i cili lobohet,
- emrin dhe mbiemrin e lobistit, perkatesisht perfaqesuesit e organizates se lobit dhe emertimin e organizates se lobit dhe numrin dhe daten e aktvendimit per regjistrim ne Regjister,
- sferen e lobimit dhe lenden e diskutimit, perkatesisht qellimin e lobimit, me pershkrim te shkurter,
- te dhena per porositesin e lobimit,
- daten, vendin dhe menyren e realizimit te kontaktit me qellim lobimin (ne tekstin e metejme: procesverbali).

(2) Personi te i cili eshte lobuar detyrohet te dergoje kopje te procesverbalit ne Komisionin Shteteror ne afat prej tete ditesh nga dita e realizimit te kontaktit, per botim ne Regjister.

(3) Formen dhe permbajtjen e formularit per procesverbalin i percakton Komisioni Shteteror.

### Neni 21

(1) Komisioni Shteteror kryen kontroll formal te procesverbalit gjate pranimi te tij.

(2) Nese Komisioni Shteteror gjate kontrollit nga paragrafi (1) i ketij neni, percakton se procesverbali eshte jo i plote, do te kerkoje nga personi tek i cili eshte lobuar ku ne afat prej tete ditesh te dorezoje procesverbal te plote.

### Neni 22

(1) Komisioni Shteteror kryen kontroll te permbajtjes se procesverbalit pas marrjes se parashtreses ose pas informates se arritur, brenda 20 ditesh, ne pajtim me nenin 18 te ketij ligji.

(2) Per qellimet e kontrollit nga paragrafi (1) i ketij neni, lobuesit, organizatat lobuse, perfaqesuesit e organizatave te lobit, porositesit e lobimit dhe organet shtetere, jane te detyruara te veprojne sipas kerkeses se Komisionit Shteteror brenda 15 ditesh.



### **Neni 23**

(1) Personi te i cili eshte lobuar eshte i detyruar te parashtroje parashtrese te Komisioni Shteteror nese lobuesi ose organizata e lobit, perkatesisht perfaqesuesi i organizates se lobit vepron ne kundershtim te dispozitave te ketij ligji, brenda 10 ditesh nga realizimi i kontaktit me lobuesin ose organizaten e lobit, perkatesisht perfaqesuesin e organizates se lobit.

(2) Komisioni Shteteror brenda tri ditesh, nga dita e pranimit e dorezon parashtresen nga paragrafi (1) i ketij neni, te lobuesi, perkatesisht organizata e lobit te ciles i perket, ku brenda 10 ditesh lobuesi, perkatesisht organizata e lobit te prononcohet ne lidhje me pohimet e shprehura ne parashtrese.

(3) Komisioni Shteteror brenda 20 ditesh, nga marrja e parashtreses nga paragrafi (1) i ketij neni, konstaton ekzistim te shkeljes se dispozitave te ketij ligji nga lobuesi ose organizata e lobit, perkatesisht perfaqesuesi i organizates se lobit dhe vendos per ngritjen e procedures kundervajtese dhe/ose shlyerje nga Regjistri ne pajtim me dispozitat e ketij ligji.

(4) Per shkak te veprimit, sipas parashtreses nga paragrafi (1) i ketij neni, Komisioni Shteteror zbaton kontroll ne pajtim me nenin 18 te ketij ligji.

(5) Per qellimet e kontrollit nga paragrafi (4) i ketij neni, lobuesit, organizatat e lobimit, perfaqesuesit e organizatave te lobit, porositesit e lobimit dhe organet shteterore, jane te detyruara te veprojne sipas kerkeses se Komisionit Shteteror brenda 15 ditesh.

## **IV. DETYRIMET E ORGANEVE TE PUSHTETIT LEGJISLATIV DHE EKZEKUTIV DHE TE ORGANEVE TE NJESIVE TE VETQEVERISJES LOKALE**

### **Neni 24**

(1) Organet te te cilat lobohet jane te detyruara me akte te brendshme te percaktojne procedura, perkatesisht rregulla me te cilat do te rregullohen:

- realizimi dhe evidenca e kontakteve me qellim lobimin,
- identifikimi dhe evidenca e personave te cilet realizojne kontakte ne institucione, proceset transparente te pergatitjes, miratimit dhe ndryshimit te politikave publike, perkatesisht programeve, ligjeve ose akteve nenligjore ose akteve te tjera te pergjithshme, te cilat perfshijne shpalljen e te dhenave per identitetin e te gjithe pjesemarresve ne proces, subjektet interesat e te cileve jane perfaqesuar, kushtet ne te cilat eshte realizuar pjesemarrja dhe kompensimet e paguara per te njejten,
- shpallja proaktive e njoftimeve per takimet dhe mbledhjet zyrtare te realizuara, me te dhena per pjesemarresit e pranishem dhe lenden e diskutimit.

(2) Organet te te cilat lobohet jane te detyruara qe brenda 30 ditesh nga miratimi i akteve te brendshme nga paragrafi (1) nenpika 1 te ketij neni, ta njoftojne Komisionin Shteteror per procedurat e percaktuara, perkatesisht rregulla nga paragrafi (1) te ketij neni dhe t'i dorezojne aktet e brendshme te Komisioni Shteteror per shpallje ne Regjister.

### **Neni 25**

(1) Organet te te cilat lobohet jane te detyruara qe ne faqet e veta te internetit te publikojne te dhena per identitetin e pjesemarresve ne proceset e pergatitjes, miratimit dhe ndryshimit te politikave publike perkatesisht programeve, ligjeve ose akteve nenligjore ose akteve te tjera te pergjithshme, subjektet interesat e te cileve jane perfaqesuar, kushtet ne te cilat pjesemarrja eshte realizuar dhe kompensimet e paguara gjate procesit, brenda pese dite pune pas perfundimit te proceseve.

(2) Me perjashtim te paragrafit (1) te ketij neni, organet te te cilat lobohet mund ta kufizojne transparencen e proceseve dhe publikimin e te dhenave te cilat paraqesin informate te klasifikuar me

shkalle perkatese te klasifikimit ne pajtim me ligjin, me ate qe do t'i ndajne ato te dhena, kurse te tjerat do t'i bejne publikisht te arritshme pa u rrezikuar, me kete rast siguria e informatave te klasifikuara.

#### **Neni 26**

(1) Komisioni Shteteror zbaton aktivite per zhvillimin e vetedijes publike dhe institucionale per lobim dhe jep udhezime per zbatim te drejte te dispozitave te ketij ligji me kerkese te organeve te cilat lobohet.

(2) Aktivitetet nga paragrafi (1) i ketij neni i parasheh Komisioni Shteteror me planin e vet vjetor te punes.

### **VII. MBIKEQYRJA**

#### **Neni 27**

(1) Mbikeqyrje ndaj zbatimit te dispozitave te ketij ligji kryen Komisioni Shteteror.

(2) Per zbatimin e ketij ligji Komisioni Shteteror informon ne kuader te raportit te vet vjetor te punes.

### **VIII. DISPOZITA KUNDERVAJTESE**

#### **Neni 28**

(1) Gjobe ne shume prej 300 deri ne 500 euro ne kundervlere me denarin, do t'i shqiptohet per kundervajtje personit te zgjedhur ose emeruar, sekretarit ne njesi te vetadministrimit lokal, sekretarit te pergjithshem, sekretarit shteteror ose personit pergjegjes ne ndermarrje publike ose institucion publik te themeluar nga organi, teK i cili lobohet ose personit pergjegjes ne organizate me autorizime publike nese:

- kryen lobim sa i zgjat mandati (neni 7 paragrafi (1)) i ketij ligji,
- kryen lobim para kalimit te tre viteve, nga dita e pushimit te mandatit (neni 7 paragrafi (2)) i ketij ligji.

(2) Gjobe ne shume prej 300 deri ne 500 euro ne kundervlere me denarin, do t'i shqiptohet per kundervajtje keshilltarit te posacem ne organ te i cili lobohet, nese:

- kryen lobim nderkohe qe eshte i punesuar ne organin, teK i cili lobohet (neni 7 paragrafi (3)) i ketij ligji,
- kryen lobim para kalimit te nje viti nga dita e pushimit te punesimit, perkatesisht angazhimit ne organin te i cili lobohet (neni 7 paragrafi (4)) i ketij ligji.

(3) Gjobe ne shume prej 200 euro ne kundervlere me denarin do t'i shqiptohet per kundervajtje personit te punesuar ne organin te i cili lobohet, e i cili nuk eshte keshilltar i posacem, nese:

- kryen lobim nderkohe qe eshte i punesuar ne organ te i cili lobohet (neni 7 paragrafi (3)) nga ky ligj,
- kryen lobim para kalimit te nje viti nga dita e pushimit te punesimit ne organ te i cili lobohet (neni 7 paragrafi (4)) nga ky ligj.

#### **Neni 29**

(1) Gjobe ne shume prej 500 deri ne 1.000 euro ne kundervlere me denarin do t'i shqiptohet per kundervajtje personit juridik (organizates se lobit) nese:

- per shkak te lobimit pranon, jep ose premtion donacione, dhurata, sherbime, ndikime, privilegje ose perparesi te tjera per vete ose per te tjeter (neni 14 paragrafi (1)) nga ky ligj,
- propozon ose ndermerr aktivite ose organizon dhe realizon kontakte me cfare do ta vendose personin te i cili lobon ne gjendje te konfliktit te interesave ose do t'i shkaktoje ndjenje detyrimi ndaj organizates se lobit (neni 14 paragrafi (2)) nga ky ligj,

- kryen njekohesisht, perkatesisht paralelisht lobim ne lidhje me ceshtjen e njejte ne fushe te caktuar drejtuar ndaj realizimit te interesave, aktvendimeve, perkatesisht rezultateve kundershuese (neni 14 paragrafi (3)) nga ky ligj,
  - u jep informata te pasakta ose jo te plota personave te te cilet lobon ne lidhje me statusin e cilesise ose per porositesin e lobimit ne emrin e te cilit lobohet (neni 15 paragrafi (1)) nga ky ligj,
  - shfrytezon, zbulon informate ose dokument te cilin e ka marre nga personi te i cili lobon, ne kundershitim me qellimet per te cilat e ka marre informaten, perkatesisht dokumentin (neni 15 paragrafi (2)) nga ky ligj,
  - nuk vepron sipas kerkeses se Komisionit Shteteror per informata plotesuese per kontroll te teresise ose vertetesise se raportit nga neni 16 te ketij ligji, procesverbalit ose ne menyre tjeter e pengon kontrollin nga neni 13 paragrafi (2), neni 18 dhe neni 22 i ketij ligji.
- (2) Gjore ne shume prej 500 deri ne 1.000 euro ne kundervlere me denarin do t'i shqiptohet per kundervajtje personit juridik nese kryen lobim edhe pse nuk eshte regjistruar ne Regjister si organizate e lobit ose eshte shlyer nga Regjistri.
- (3) Gjore ne shume prej 200 eurosh ne kundervlere me denarin do t'i shqiptohet personit pergjegjes ne personin juridik per kundervajtjet e percaktuara ne paragrafet (1) dhe (2) te ketij neni.
- (4) Gjore ne shume prej 200 eurosh ne kundervlere me denarin do t'i shqiptohet personit fizik (lobues) per kundervajtje te percaktuara ne paragrafin (1) te ketij neni.
- (5) Per kundervajtjet e percaktuara ne paragrafin (1) te ketij neni personit juridik (organizates se lobit) dhe personi fizik (lobues ose perfaqesues i organizates se lobit), Komisioni Shteteror do t'u percaktoje pezullim te se drejtes se reregjistrimit ne Regjister me kohezgjatje nje vit, ne pajtim me nenin 13 te ketij ligji.

### **Neni 30**

- (1) Gjore ne shume prej 500 deri ne 1.000 euro ne kundervlere me denarin do t'i shqiptohet per kundervajtje personit juridik (organizates se lobit) nese:
- nuk dorezon raport me shkrim per punen e tij te Komisioni Shteteror ne afatin e percaktuar me nenin 16 paragrafin (1) te ketij ligji,
  - nuk e ruan dokumentin ne baze te te cilit ka parashtruar raport te Komisioni Shteteror, ne afat te percaktuar me nenin 16 paragrafi (3) te ketij ligji,
  - nuk dorezon raport te plote per punen e tij te Komisioni Shteteror ne afatin e percaktuar me nenin 17 paragrafi (2) te ketij ligji,
  - Komisioni Shteteror konstaton te dhena te paverteta nga fleteparaqitja e parashtruar per regjistrimin ne Regjister.
- (2) Gjore ne shume prej 200 eurosh ne kundervlere me denarin, do t'i shqiptohet personit pergjegjes ne personin juridik (organizates se lobit) per kundervajtjet e percaktuara ne paragrafin (1) te ketij neni.
- (3) Gjore ne shume prej 200 eurosh ne kundervlere me denarin do t'i shqiptohet personit fizik (lobues) per kundervajtjet e percaktuara ne paragrafin (1) te ketij neni.
- (4) Per kundervajtje te percaktuara ne paragrafin (1) te ketij neni personit juridik (organizate lobuse) dhe personit fizik (lobues ose perfaqesues i organizates se lobit), Komisioni Shteteror do t'i percaktoje suspendim te se drejtes per reregjistrim ne regjister ne kohezgjatje prej nje viti, ne pajtim me nenin 13 te ketij ligji.

### **Neni 31**

Gjobe ne shume prej 200 deri ne 400 euro ne kundervlere me denarin do t'i shqiptohet per kundervajtje personit te i cili eshte lobuar nese:

- nuk dergon te Komisioni Shteteror kopje te procesverbalit nga kontakti i bere me qellim te lobimit ne afatin e percaktuar ne nenin 20 paragrafi (2) te ketij ligji,
- nuk paraqet parashtrese te Komisioni Shteteror nese lobuesi ose organizata e lobit perkatesisht perfaqesuesi i organizates se lobit vepron ne kundershtim me dispozitat e ketij ligji, ne afatin e percaktuar ne nenin 23 paragrafi (1) te ketij ligji.

### **Neni 32**

Gjobe ne shume prej 300 deri ne 500 euro ne kundervlere me denarin, do t'i shqiptohet per kundervajtje personit udheheqes ne organin ku llobohet nese:

- nuk i percaktojne procedurat nga neni 24 paragrafi (1) te ketij ligji, nuk e njofton Komisionin Shteteror per procedurat e percaktuara,
- nuk i dorezojne te Komisioni Shteteror aktet e brendshme nga neni 24 paragrafi (1) nenpika 1 te ketij ligji per botim ne Regjister,
- ne faqet e veta te internetit nuk publikojne te dhena te identitetit te pjesemarrresve ne procesin e rishqyrtimit, miratimit ose ndryshimit te politikave publike, perkatesisht programeve, ligjeve, akteve nenligjore ose akteve tjera te pergjithshme, te dhena per subjektet interesat e te cileve jane perfaqesuar, kushtet ne te cilat eshte realizuar pjesemarrja dhe kompensimet e paguara gjate procesit, brenda pese dite pune pas perfundimit te procesit (neni 25 te ketij ligji).

### **Neni 33**

(1) Per kundervajtjet e percaktuara me kete ligj procedure per kundervajtje udheheq dhe sanksione kundervajtese shqipton Komisioni per Kundervajtje ne Komisionin Shteteror.

(2) Anetaret e Komisionit per Kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni jane persona zyrtare te autorizuar ne Sekretariat me shkalle dhe lloj perkates te pergatitjes profesionale dhe pervoje pune te nevojshme te percaktuar me ligj, nga te cilet se paku nje prej anetareve eshte jurist i diplomuar me provim te dhene te jurisprudences.

(3) Para paraqitjes se kerkeses per ngritjen e procedures kundervajtese, mbahet procedure e barazimit me leshimin e urdherpageses per kundervajtje, ne perputhje me Ligjin per Kundervajtje.

(4) Personat zyrtare te autorizuar nga paragrafi (2) i ketij neni, jane te detyruar te mbajne evidence per urdherpagesat per kundervajtje dhe per rezultatin e procedurave te ngritura.

(5) Ne evidencen nga paragrafi (4) i ketij neni grumbullohen, perpunohen dhe ruhen te dhenat ne vijim: emri dhe mbiemri ose emri i kryesit te kundervajtjes, vendbanimi, perkatesisht vendqendrimi, selia, lloji i kundervajtjes, numri i urdherpagesave per kundervajtje dhe rezultati i procedures.

(6) Te dhenat personale nga paragrafi (5) i ketij neni mbahen pese vjet nga dita e futjes ne evidence.

(7) Formen dhe permbajtjen e urdherpagesave per kundervajtje i percakton Komisioni Shteteror.

### **Neni 34**

Percaktimi i gjobes kryhet ne pajtim me Ligjin per Kundervajtje.

### **Neni 35**

Realizimi i te drejtes per mjet juridik per gjoben e shqiptuar dhe procedura per te kryhet ne pajtim me Ligjin per Kundervajtje.

## IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

### **Neni 36**

- (1) Aktet nenligjore te percaktuara me kete ligj do te miratohen brenda 6 muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.
- (2) Aktet e brendshme nga neni 24 i ketij ligji do te miratohen brenda gjashte muajsh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

### **Neni 37**

Me ditën e fillimit të zbatimit të ketij ligji shfuqizohet Ligji për Lobim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 106/2008 dhe 135/11).

### **Neni 38**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa do të fillojë të zbatohet një vit nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.